



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
Kuvendi i Komunës Rahovec  
Opština Skupština / Opština / Municipality of Rahovec



Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/22 Nr. i faq./Br.str./No.pg 407

Data/Datum/Date 28.12.2022

Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17, nenit 24 dhe nenin 40 të Ligjit Nr. 03/L040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.9, nenit 57 dhe nenit 63 të Statutit të Komunës Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në Rahovec në mbledhjen e mbajtur me dt. 28.12.2022 miraton këtë:

### V E N D I M

#### Për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për vitin 2022

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës me Nr. Prot. 02/3104/22 i datës 09.12.2022 dhe merret vendimi me të cilin i lejohet Kryetarit të Komunës, që në interes të qytetarëve, në emër të mbulimit të shpenzimeve të varrimit për vitin 2023, të lidh marrëveshje me të gjitha bashkësitë fetare që veprojnë në territorin e komunës së Rahovecit, konform planit buxhetor afatmesëm (mbështetje në mbulimin e shërbimeve të varrimit).
2. Pakoja e shërbimeve primare do të definohet në marrëveshje të re dhe ajo nuk mund të ketë kosto më të lartë se **220.00 € (dyqind e njëzet euro)** për një rast, ndërsa për shërbimet tjera të cilat nuk janë pjesë e marrëveshjes, qytetarët do t'i sigurojnë ato personalisht.
3. Qytetarët të cilët do të marrin shërbim nëpërmjet bashkësive fetare, do të pajisen me një fletushkë me të cilën do të informohen për shërbimet të cilat janë pjesë e marrëveshjes.
4. Shërbimet të cilat do të jenë pjesë e marrëveshjes, në asnjë rast nuk mund të kushtëzohen me pagesat e anëtarësive fetare apo të tjera.
5. Obligohet Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, që në kuadër të implementimit të marrëveshjes t'i respektoj afatet kohore, si dhe të kërkoj prej bashkësisë fetare (palëve nënshkruese të marrëveshjes) që t'i përmbahen të gjitha pikave të marrëveshjes si dhe obligimeve në kompletimin e dokumentacionit konform saj.
6. Mjetet të sigurohen nga kodi **Mallra dhe Shërbime**.
7. Për zbatimin e këtij vendimi do të jetë Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në Komunën së Rahovecit.
8. Pas miratimit nga Kuvendit të Komunës në Rahovec, ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

#### Vendimi u dërgohet:

- Kryetarit të Komunës,
- Shërbimit të Kuvendit,
- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËSNË RAHOVEC

01 Nr. 407/22  
Datë: 28.12.2022

